



REPUBLIKA E SHQIPERISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME LEZHË SH.A

Data: 17.04.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: Shërbim lyerje per ambjentet e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë Sh.A

Referenca: REF-82462-04-18-2026

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45442110-1 lyerje ndertesash

Vlera e fondit limit: 1 460 446 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind dyzetë e gjashtë) Lek, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujesjelles Kanalizime Rajoni Lezhë Sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas Shtojcës 9 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Vendosja e këtij kriteri synon të provojë që operatorët ekonomikë kanë kapacitet financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës. Përqindja e kërkuar është në përpjesëtim me vlerën e kontratës dhe nuk krijon kufizime të panevojshme për konkurrencën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

a) Kur kontratat e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose
- faturat tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe natyra e punimeve të realizuara.

b) Kur kontratat e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- faturat tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe natyra e punimeve të realizuara..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qene se kjo procedure prokurimi do te konkludoje me nje kontrate shërbimi per te deshmuar pervojen e meparshme vlera totale e kërkuar

duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë profesionale të shoqërisë, të lëshuar nga institucioni përgjegjës, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, që të përfshijë minimalisht:

- **NP-3A** – Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash.

Argumentimi: Kërkesa është vendosur bazuar në shërbimin që do të realizohet sipas objektit të prokurimit. Operatori ekonomik që do të realizojë shërbimin duhet të zotërojë licencën profesionale me siper ku përfshihen shërbimet si riparime suvatimi, hidroizolim dhe lyerje fasadash. Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.759 datë 28.12.2016 (i ndryshuar).

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar **minimumi 4 (katër) punonjës**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave. Kjo e vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi minimumi për muajin e fundit të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë bazohet në Nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 dhe në Nenin 41, pika 4, gërma “c” të VKM Nr. 285/2021. Numri i kërkuar i punonjësve është në përputhje me volumin e punimeve dhe afatin e realizimit të kontratës, duke garantuar kapacitetin minimal njerëzor për realizimin me sukses të saj.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të shërbimeve që do të kryhen në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të jete Inxhinier ndërtimi ose teknik ndërtimi, të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i shërbimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e shërbimit objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Punonjes I izolimeve (Hidroizolues)	1
Murator+Suvatues	1
Bojaxhi	2

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me realizimin e suksesshëm te shërbimit për objektin.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e shërbimit, përfshirë skelat, të cilat mund të jenë në pronësi ose me qira.

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; c) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huaperdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 10 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente

mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Sipas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4, dhe në Nenin 39, pika 6, gërma “d” të VKM Nr. 285/2021. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Disponimi i pajisjeve është i domosdoshëm për realizimin e punimeve në kohë dhe sipas standardeve të kërkuara, duke garantuar siguri dhe efikasitet gjatë ekzekutimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikate si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001-2015 e perditesuar** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.8 gërma “a”- “b” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

Kategoritë e kërkuara janë bazuar në specifikat e shërbimit të nevojshëm si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i Shërbimit	Njesia	Sasia	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit/dite
1	Prishje suvatimesh të jashtme dhe largimi i tyre me transport	m ²	36	SHRUKL	20 dite

2	Prishje suvatimesh te brendshme dhe largimi i tyre me transport	m ²	67	SHRUKL	20 dite
3	Riparim suvatimesh te jashtme fasade	m ²	36	SHRUKL	20 dite
4	Riparim suva ambjent brenda	m ²	67	SHRUKL	20 dite
5	Riparim suva solete	m ²	23	SHRUKL	20 dite
6	Riparim hidroizolim tarrace	m ²	9.5	SHRUKL	20 dite
7	F.V. Lyerje me hidromat(muret brenda, tavanet)	m ²	1920	SHRUKL	20 dite
8	F.V. Fasade me boje kundra lageshtires	m ²	755	SHRUKL	20 dite
9	F.V skela	m ²	755	SHRUKL	20 dite

Afatet i shebimit: 20 dite nga nenshkrimi i kontrates

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 (e ndryshuar), duke përshkruar qartë natyrën, përmasën dhe karakteristikat e punimeve që do të realizohen.

Zërat e përcaktuar në tabelë (prishje dhe riparim suvatimesh, hidroizolim, lyerje të brendshme dhe të jashtme, si dhe vendosje skelash) janë të lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe përfaqësojnë punime standarde të mirëmbajtjes dhe rikonstruksionit të ambienteve.

Përcaktimi i njësive, sasive dhe afatit të realizimit është bërë për të garantuar qartësi në ofertim, krahasueshmëri të ofertave dhe realizim korrekt të kontratës. Specifikimet teknike nuk përmbajnë referenca kufizuese apo elementë diskriminues dhe janë në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke garantuar pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë të licencuar në fushën përkatëse.

Të gjitha kriteret e vendosura janë në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 dhe VKM Nr. 285/2021, janë proporcionale me natyrën dhe përmasën e kontratës dhe nuk krijojnë pengesa të pajustificuara për konkurrencën, duke garantuar njëkohësisht realizimin me sukses të kontratës

Njesia e Prokurimit